



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

V E N D I M

Nr. 4, datë 16.2. 2016

PËR

**PROPOZIMIN, PËR MIRATIM, NË KËSHILLIN E MINISTRAVE,
TË PROJEKTVENDIMIT “PËR MIRATIMIN E KUFIJVE
TERRITORIALË E HIDROGRAFIKË TË BASENEVE UJORE
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, SI DHE QENDRËN
DHE PËRBËRJEN E KËSHILLIT TË SECILIT PREJ TYRE”**

Në mbështetje të shkronjës “a”, të pikës 3, të nenit 8, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I:

1. Territori i Republikës së Shqipërisë, në funksion të administrimit të burimeve ujore, ndahet në gjashtë basene ujore, me qendrat përkatëse, si më poshtë vijon:
 - a) Baseni ujq Drin-Bunë, me qendër në Shkodër;
 - b) Baseni ujq Mat, me qendër në Lezhë;
 - c) Baseni ujq Ishëm- Erzen, me qendër në Tiranë;
 - ç) Baseni ujq Shkumbin, me qendër në Elbasan;
 - d) Baseni ujq Seman, me qendër në Fier;
 - dh) Baseni ujq Vjosë, me qendër në Vlorë.
2. Përcaktimi i kufijve territorialë të çdo baseni është sipas hartës administrative, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Përcaktimi i kufijve hidrografikë të çdo baseni është sipas hartave respektive të çdo baseni ujq, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

4. Administrimi i integruar i burimeve ujore në Republikën e Shqipërisë, në nivel baseni ujqor, të kryhet mbi bazën e kufijve të rinj territorialë, të përcaktuar nga analiza e kufijve hidrografikë, sipas hartave bashkëlidhur këtij vendimi.
5. Për çdo basen ujqor funksionon Agjencia e Basenit Ujqor (ABU), në zbatim të kërkesave të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e integruar të burimeve ujore.
6. Për çdo basen ujqor funksionon Këshilli i Basenit Ujqor (KBU), në zbatim të kërkesave të legjislacionit në fuqi për administrimin e burimeve ujore.
7. Numri i anëtarëve, për çdo këshill të basenit ujqor, të jetë:

a) Baseni ujqor Drin-Bunë	23 anëtarë;
b) Baseni ujqor Mat	15 anëtarë;
c) Baseni ujqor Ishëm- Erzen	21 anëtarë;
ç) Baseni ujqor Shkumbin	17 anëtarë;
d) Baseni ujqor Seman	29 anëtarë;
dh) Baseni ujqor Vjosë	27 anëtarë.
8. Kryetari i KBU-së do të jetë prefekti i prefekturës më të madhe të qarkut në basenin ujqor, i cili do të jetë në këtë funksion për aq kohë sa ushtron detyrën si prefekt.
9. Nënkryetari i KBU-së të zgjidhet nga Këshilli i Basenit Ujqor.
10. Sekretari i KBU-së të jetë drejtuesi i agjencisë së basenit ujqor, i emëruar nga ministri përgjegjës për menaxhimin e burimeve ujore.
11. Përbërja e anëtarëve të këshillave të gjashtë baseneve ujore të jetë, si më poshtë vijon:
 - 11.1 Këshilli i Basenit Ujqor Drin-Bunë:
 - a) Prefekti i Shkodrës, (kryetar).
 - b) Drejtues të nivelit të lartë në bashki, të emëruar nga kryetarët përkatës të bashkive:
 - Malësi e Madhe, një anëtar;
 - Tropojë, një anëtar;
 - Shkodër, një anëtar;

- Fushë-Arrëz, një anëtar;
- Has, një anëtar;
- Vau i Dejës, një anëtar;
- Pukë, një anëtar;
- Kukës, një anëtar;
- Dibër, një anëtar;
- Lezhë, një anëtar;
- Bulqizë, një anëtar;
- Librazhd, një anëtar;
- Pogradec, një anëtar.

c) Drejtues të institucioneve lokale:

- Agjencia rajonale e mjedisit, (një anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU- së);
- Administrata e zonave të mbrojtura, (një anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);
- Drejtoritë rajonale të shëndetit publik, (dy anëtarë, të miratuar nga kryetari i KBU-së).

ç) Grupet e interesit për:

- Mbrojtjen e burimeve ujore, (një anëtar i shoqatave mjedisore, i miratuar nga kryetari i KBU-së);
- Furnizimin me ujë, (një anëtar i shoqatave, i miratuar nga kryetari i KBU- së);
- Ujitjen, (një anëtar i miratuar, nga kryetari i KBU-së);
- Hidroenergjinë dhe industrinë, (dy anëtarë, të miratuar nga kryetari i KBU-së).

11.2 Këshilli i Basenit Ujor Mat:

a) Prefekti i Lezhës (kryetar).

b) Drejtues të nivelit të lartë në bashki, emëruar nga kryetarët përkatës të bashkive:

- Mirditë, një anëtar;
- Kurbin, një anëtar;
- Mat, një anëtar;
- Klos, një anëtar;
- Fushë-Arrëz, një anëtar;
- Pukë, një anëtar;
- Lezhë, një anëtar;
- Bulqizë, një anëtar.

c) Drejtues të institucioneve lokale:

- Agjencia rajonale e mjedisit, (një anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);
- Drejtoritë rajonale të shëndetit publik, (një anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së).

ç) Grupet e interesit për:

- Mbrojtjen e burimeve ujore, (një anëtar i shoqatave mjedisore, i miratuar nga kryetari i KBU-së);
- Furnizimin me ujë, (një anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);
- Ujitjen, (një anëtar i miratuar, nga kryetari i KBU-së);
- Hidroenergjinë dhe industrinë, (një anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së).

11.3 Këshilli i Bascnit Ujor Ishëm-Erzen:

a) Prefekti i Tiranës (kryetar).

b) Drejtues të nivelit të lartë në bashki, emëruar nga kryetarët përkatës të bashkive:

- Krujë, një anëtar;
- Durrës, një anëtar;
- Vorë, një anëtar;
- Tiranë, një anëtar;
- Shijak, një anëtar;
- Kamëz, një anëtar;
- Kurbin, një anëtar.

c) Drejtues të institucioneve lokale:

- Agjencia rajonale e mjedisit, (një anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);
- Administrata e zonave të mbrojtura, (një anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);
- Drejtoritë rajonale të shëndetit publik, (një anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);
- Autoriteti shëndetësor rajonal Tiranë, (një anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së).

ç) Grupe interesi për:

- Mbrojtjen e burimeve ujore, (dy anëtarë të shoqatave mjedisore, të miratuar nga kryetari i KBU-së);

- Furnizimin me ujë, (dy anëtarë, të miratuar nga kryetari i KBU-së);
- Ujitjen, (dy anëtarë, të miratuar nga kryetari i KBU-së);
- Hidroenergjinë dhe industrinë, (tre anëtarë, të miratuar nga kryetari i KBU-së).

11.4 Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin:

a) Prefekti i Elbasanit (kryetar).

b) Drejtues të nivelit të lartë në bashkitë, të emëruar nga kryetarët përkatës të bashkive:

- Librazhd, një anëtar;
- Elbasan, një anëtar;
- Rrogozhinë, një anëtar;
- Kavajë, një anëtar;
- Peqin, një anëtar;
- Pogradec, një anëtar;
- Prrenjas, një anëtar;
- Divjakë, një anëtar.

c) Drejtues të institucioneve lokale:

- Agjencia rajonale e mjedisit, (një anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);
- Administrata e zonave të mbrojtura, (një anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);
- Drejtoritë rajonale të shëndetit publik, (dy anëtarë, të miratuar nga kryetari i KBU-së).

ç) Grupe interesi për:

- Mbrojtjen e burimeve ujore, (një anëtar i shoqatave mjedisore, i miratuar nga kryetari i KBU-së);
- Furnizimin me ujë, (një anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);
- Ujitjen, (një anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);
- Hidroenergjinë dhe industrinë, (një anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së).

11.5 Këshilli i Basenit Ujor Seman:

a) Prefekti i Fierit (kryetar).

b) Drejtues të nivelit të lartë në bashkitë, të emëruar nga kryetarët përkatës të bashkive:

- Divjakë, një anëtar;
- Lushnjë, një anëtar;
- Belsh, një anëtar;
- Cërrik, një anëtar;
- Gramsh, një anëtar;
- Kuçovë, një anëtar;
- Ura Vajgurore, një anëtar;
- Roskovec, një anëtar;
- Patos, një anëtar;
- Fier, një anëtar;
- Pustec, një anëtar;
- Maliq, një anëtar;
- Berat, një anëtar;
- Korçë, një anëtar;
- Devoll, një anëtar;
- Skrapar, një anëtar;
- Poliçan, një anëtar;
- Kolonjë, një anëtar;
- Elbasan, një anëtar;
- Mallakastër, një anëtar.

c) Drejtues të institucioneve lokale:

- Agjencia rajonale e mjedisit, (një anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);
- Administrata e zonave të mbrojtura, (një anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);
- Drejtoritë rajonale të shëndetit publik (dy anëtarë, të miratuar nga kryetari i KBU-së).

ç) Grupe interesi për:

- Mbrojtjen e burimeve ujore, (një anëtar i shoqatave mjedisore, i miratuar nga kryetari i KBU-së);
- Furnizimin me ujë, (një anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);
- Ujitjen, (një anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);
- Hidroenergjinë dhe industrinë, (një anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së).

11.6 Këshilli i Basenit Ujor Vjosë:

- a) Prefekti i Vlorës (kryetar).

b) Drejtues të nivelit të lartë në bashki, të emëruar nga kryetarët përkatës të bashkive:

- Mallakastër, një anëtar;
- Përmet, një anëtar;
- Këlcyrë, një anëtar;
- Memaliaj, një anëtar;
- Selenicë, një anëtar;
- Vlorë, një anëtar;
- Himarë, një anëtar;
- Sarandë, një anëtar;
- Gjirokastër, një anëtar;
- Tepelenë, një anëtar;
- Libohovë, një anëtar;
- Dropull, një anëtar;
- Finiq, një anëtar;
- Delvinë, një anëtar;
- Konispol, një anëtar;
- Fier, një anëtar;
- Kolonjë, një anëtar.

c) Drejtues të institucioneve lokale:

- Agjencia rajonale e mjedisit, (një anëtar, të miratuar nga kryetari i KBU-së);
- Administrata e zonave të mbrojtura, (një anëtar, të miratuar nga kryetari i KBU-së);
- Drejtoritë rajonale të shëndetit publik (dy anëtarë, të miratuar nga kryetari i KBU-së).

ç) Grupe interesi për:

- Mbrojtjen e burimeve ujore, (një anëtar i shoqatave mjedisore, i miratuar nga kryetari i KBU-së);
- Furnizimin me ujë, (një anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);
- Ujitjen, (një anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);
- Hidroenergjinë dhe industrinë, (dy anëtarë, të miratuar nga kryetari i KBU-së).

12. Vendimi nr.5, datë 22.12.1998, "Për ndarjen e territorit të Republikës së Shqipërisë në basene ujëmbledhëse dhe për krijimin e Agjencive të Ujit për këto basene" dhe vendimi nr.1, datë 19.7.2002, "Për krijimin e këshillave të baseneve ujëmbledhës", të ndryshuar, të Këshillit Kombëtar të Ujit shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

13. Ngarkohen organet kombëtare të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore për zbatimin e këtij vendimi.
14. Ngarkohet ministri propozues të ndjekë procedurën ligjore për shqyrtimin dhe miratimin e këtij akti në Këshillin e Ministrave.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


KRYETAR

EDI RAMA

MINISTRI

EDMOND PANARITI





Harta ADMINISTRATIVE


Legjenda

- Qytetet
 - Bashkite
 - Hidrografia
- ### Basenet
- Drini
 - Ishem-Erzen
 - Mat
 - Semani
 - Shkumbini
 - Vjosa

Projekcioni : ETRS 1989
 Rrini : të dhënzave : Ministria e Shtetit për
 Cështjet Vendore
 Punuar në shkallën : 1: 200 000



Pergatitur:
 Ministria e Bujqësisë,
 Zhvillimit Rural dhe
 Administrimit të Ujerave



BASENI DRIN - BUNA

Legjenda

- Rrethet e BUNës
- Fshatrat
- Qytete

Projeksioni : ETRS 1989
 Biriçini i të dhënave : A:CM
 Punuar në shkallën : 1:150 000



Pergatitur:

Ministria e Bujqësisë,
 Zhvillimit Rural dhe
 Administrimit të Ujërave

BASENI I MATIT


Legjenda


- Baseni MATIT
- Hidrografia
- Qytetet

Projeksioni : ETRS 1989
Burimi i te dheneve : AKM
Punuar ne shkallen : 1:100 000



Pergatitur:
Ministria e Bujqesise,
Zhvillimit Rural dhe
Administrimit te Ujtrave





BASENI ISHEM - ERZENI

Legjenda

- Baseni Ishem - Erzeni
- Hidrografia
- Qytet

Projeksioni : ETRS 1989
 Burimi i të dhënave : AKM
 Punuar në shkallën : 1: 100 000



Pergatitur:
 Ministria e Bujqësisë,
 Zhvillimit Rural dhe
 Administrimit të Ujerave

19° 20' 41"

20° 41'

BASENI I SHKUMBINIT


Legjenda


- Baza e Shkumbinit
- Kuvend
- Qendër

PROJEKTOI: : 2015/10/18
 Bashkia e Ohresve : 4000
 Planuar ne shkallën : 1:100.000



Pergatitur:
 Ministria e Bujqesise,
 Zhvillimit Rural dhe
 Administrimit te Ujterave





<p>BASENI I SEMANIT</p> <p>Legjenda</p> <ul style="list-style-type: none"> Baseni i Semanit River City 	<p>Prodhuesi : ETIS TMS Titulli i dokumentit : AICM Për numër në shpallje : 1. 300.040</p>	<p>Pergathtar: Ministria e Kulturës, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Zjerave</p>
---	--	--

